



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. 308/2 . prot

Datë 05.06 .2025

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

REF-50281-06-05-2025

Objekti: “Blerje karburant gazoil 10ppm”.
Procedura: “E hapur e thjeshtuar”- Mall, (elektronikë).
Fondi limit: 1,250,000(një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa TVSH
Burimi: Vetëfinancim
Afati: nga lidhja e kontratës deri në 31.12.2025.
Referenca: Programi ekonomik i Shoqërisë për vitin 2025.
CPV: 09134100-8 Karburant diesel
KODI OUTPUT: 0000000
PROCEDURË E RISHPALLUR - Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit **REF-45857-04-23-2025**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **PORTI DETAR ShA SARANDË** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
 - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
 - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;
 - c. Formularin e ofertes sipas Shtojcës 2.
 - d. Formularin Lista e Çmimeve të artikujve sipas Shtojcës 3

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 25 000 (njëzet e pesë mijë) LEK.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas përcaktimeve të bera në Shtojcën 9 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-ës.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2022,2023 dhe 2024), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/pika 2(c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke qenë lloji i procedures “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenit 43, pika 2, gërma “c” të VKM nr.285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) 40% te vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....”;

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

2.2.2 Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit). Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme :

a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

2.4 KRITERE TË TJERA TË VEÇANTA

2.4.1 Subjekti duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose licensë për tregtim karburantesh në kuptim sipas Ligjit Nr.1048 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar” dhe VKM-së Nr.970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” e përditësuar me VKM Nr.344 datë 19.04.2017, përfshirë Leje/Autorizime nga Pushteti Vendor për këtë qëllim.

Si në rastin e qeramarjes ashtu edhe në rastin e kontratës së bashkëpunimit, e cila merr përsipër furnizimin e pandërprerë me karburant, e shoqëruar me dokument ligjor për disponimin e pikave ku të përcaktohet qartë vendodhja e pikës së karburantit, personat përgjegjës, si dhe formularin e vetëdeklarimit „shtojca 9“, vërtetim pagese energji elektrike, dëshmi jopenaliteti nga IQT, Leje/Autorizim nga pushteti Vendor, Leje Mjedisore, vërtetim të pagesave të taksave vendore, Akt-Teknik të leshuar nga PMNZH, Policë Sigurimi me një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

Plotësimi i formularit të vetdeklarimit „Shtojca 9“ duhet të bëhet nga të dy palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 5, germa a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.4.2 Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 1(një) stacion të tregëtimit me pakicë të karburantit, brenda territorit të qytetit Sarandë, në një distance të përshtatshme jo më shumë se 10(dhjetë) km nga Porti Detar Sarandë, vërtetuar kjo me një nga format e disponimit sipas kodit Civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie, ose të kenë kontratë furnizimi(bashkëpunimi) ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesëmarrës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, mbështetet më tepër në një llogjikë të qartë dhe të thjeshtë, që konsiston në faktin që ; automjeti për t’u furnizuar me karburant, nuk ka pse të përshkojë një distancë , po themi, më tepër se 10 km(vajtje-ardhje), duke humbur kështu kohë dhe gjithashtu duke rritur në mënyrë artificiale, jo produktive, konsumin e karburantit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një Vërtetim Teknik nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit, për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Vërtetim Teknik duhet të jetë lëshuar jo më parë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenit 40 pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe në VKM Nr.491 datë 19.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënproduktet e tyre”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që mund të dorëzojnë dëshmi për rezultate të testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Ky kriter vendoset pasi AK kërkon të garantojë që karakteristikat teknike të mallit të ofertuar të përputhen me standardet teknike të kërkuara.

2.4.4 Subjekti ofertues duhet të paraqesë dhe deklaratat si më poshtë:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant me pakicë me shërbim 24 orë, me karta elektronike / tollona. Karta/tollonat të jenë me firmën dhe vulën e furnizuesit.
- Subjekti duhet të deklarojë se kartat elektronike duhet të jetë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve detyrimisht me pistoletë publike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Shënim: Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të cilën është shpallur fitues kontraktor.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP- së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”,

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.2065 Prot, datë 12.04.2022.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet e mëposhtme i referohen Direktivës Europiane të lëndëve djegëse 98/70/EëC, Amendamentit 2003/17/EC, Amendamentit 2009/30/EC dhe 2011/63/EU si dhe Aneksit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndës djegëse benzinë dhe diesel”.

Specifikimet teknike të Gazoil 10 ppm sipas standartit SSH EN 590:2022

Tabela 1- kërkesat e përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës për karburantet automotive.

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		Metoda e provës ^a (Shiko paragrafin 2 Rekomandimet e detyrueshme)
		Minimale	Maksimale	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	EN ISO 5165 EN 15195
Indeksi i cetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820,0	845,0	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^d	% (m/m)	-	11	EN 12916
Përmbajtja e squfurit ^e	mg/kg	-	50,0 (deri 31-12-2008)	EN ISO 20846 EN ISO 20847 EN ISO 20884
			10,0	EN ISO 20846 EN ISO 20884
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	EN ISO 2719
Përmbajtja e koksit ^g (në 10 % mbetje distilimi)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Ndohtja e përgjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662 ^g
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160
(FAME) Përmbajtja e esterit metalik me acid yndyror ^h	%(V/V)	-	7,0	EN 14078
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25	EN ISO 12205



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

	h	20	-	EN 15751
Vetitë lubrifikuese, diametri i korrigtuar i njollës së gripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Distilimi ^{k, i}				EN ISO 3405
distilati që vlon në 250°C, % (V/V)	% (V/V)		< 65	
distilati që vlon në 350 °C, % (V/V)	% (V/V)	85		
distilati që vlon në 95 % (V/V) °C			360	

Shënim: Kërkesat me Bold i referohen Direktivës Evropiane të Karburanteve 98/70 /EC (1), duke përfshirë amendamentet 2003/17/EC (2), 2009/30/EC (3) dhe 2011/63/EU (4).

- a. Shih gjithashtu 5.7.1.
- b. Shih gjithashtu 5.7.4.
- c. Shih gjithashtu 5.7.2.
- d. Për qëllimet e këtij Standardi Evropian, hidrokarbonet policiklikë aromatikë janë caktuar si përmbajtja totale e hidrokarboneve aromatike më pak se përmbajtja e hidrokarboneve mono-aromatike, të dyja të përcaktuara në EN 12916.
- e. Shih gjithashtu 5.7.3.
- f. Shih gjithashtu 5.2.2.
- g. Shih gjithashtu 5.2.2. dhe Aneksi A.
- h. Investigimi i mëtejshëm për kontaminimin total në metodën e provës për përmirësimin e saktësisë, veçanërisht për prezencën e FAME, nën mbikëqyrjen e CEN.
- i. FAME i përkohet kërkesat e EN 14214, shih (3).
- j. Kur karburantet e naftës përmbajnë më shumë se 2 % (V/V) FAME , qëndrueshmëria e oksidimit të përcaktuar në EN 15751 është kërkesa për të.
- k. Për llogaritjen e indeksit të Cetanit 10%, 50 % dhe 90% (V/V) nevojiten gjithashtu pikat e RECOVERY.
- l. Limitet e distilimit në 250 gradë Celsius dhe 350 gradë Celsius janë përfshirë në tarifën e karburantit naftë të Doganave të përbashkëta të BE.
- m. EN ISO 3924 jep instruksione për konvertimin në ISO 3405-të dhëna ekuivalente. Shih gjithashtu 5.7.5.

Operatorët Ekonomikë ofertues janë të Operatorët ekonomik janë të detyruar të paraqesin në ofertat e tyre mallrat e kërkuara sipas standartit të kërkuar si më sipër.

Me paraqitjen e kërkesës nga AK, kontraktuesi është i detyruar të furnizojë automjetet e AK-së në kohën dhe sasinë e kërkuar, duke përfshirë në çmim të gjitha detyrimet fiskale të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Gazoil 10 ppm	1 250 000 leke pa TVSH 9 745 litra	Porti Detar Sh.A Sarandë	Deri më 31.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“PORTI DETAR” SH.A. SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

\$				
A				

Llogaritja e sasisë të pritshme është bërë referuar cmimit \$/ton I publikuar nga Bursa PLATSS e datës 04.06.2025 si dhe kursit të këmbimit valutor zyrtar I Bankës të Shqipërisë i të njëjtës datë.

Sasia e mallit që kërkohet (orientuese me marxh fitimi 10%):

KUJ DES!

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Pas hartimit dhe miratimit me unanimitet të dokumenteve të tenderit dhe kritereve për kualifikim Njësia e prokurimit, në zbatim të pikës 3, të manualit teknik “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike*”, miratuar me udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021 të APP, autorizoi R. A. për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje karburant gazoil 10ppm*” për automjetet dhe gjeneratorët e Portit Detar ShA Sarandë , dhe në zbatim të nenit 49, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, vendosi si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave :

Data: 20/06/2025 (d/m/v) ora 13:00

Dokumentacioni i cili do të ngarkohet në SPE:

DST- Karburant

Proces Verbal Argumentimi i Kritereve.

NJËSIA E PROKURIMIT: